

85H-1

K 52

VJERSHA



KENGE E
THJESHTË

891.983-1

K B 2

J

KËNGË E THJESHTË

(VIERSHA)

~~52343~~

~~LIBRIKË E [REDACTED]~~
~~129 F6~~

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DY FJALË LEXUESIT

Ky vëllim me poezi, është pregatitur nga rrethi letrar i qytetit të Durrësit në kuadrin e njëzet e pesë vjetorit të çlirimit të Atdheut. Janë përfshirë poezi, për fëmijë të moshës shkollore, shkruar nga anëtarë të rrethit letrar dhe nxënës të shkollave tetëvjeçare e të mesme të qytetit tonë. Shumica e këtyre letrarëve i muarën në dorë penat për herë të parë dhe hodhën në vargje ndjenjat e tyre të zjarra të dashurisë së pakufishme për atdheun socialist, për Partinë tonë të Punës dhe për Udhëheqësin e dashur e të madh, shokun Enver Hoxha.


Nëpërmjet këtij botimi, ata vunë në dukje se sa e gjerë dhe e gjithanshme është mundësia dhe horizonti që ka çelur Partia jonë përpara të rinjve në çdo fushë të aktivitetit të tyre.

Duke marrë inisiativën për botimin e këtij vëllimi të përbashkët, të rinjtë e shkollave të qytetit tonë

dhe anëtarët e rrethit letrar të pallatit të kulturës «Aleksandër Moisiu», japin një shembull të mirë se si duhet të veprohet me shkrimet që mbushin sirtaret e rretheve të shkollave, vatrave dhe shtëpive të kulturës.

Botimi i këtij vëllimi është një inkurajim për autorët e vegjël dhe i gëzon shumë ata e shokët e tyre.

Ethem Hysi



DRITAT E PARTISË

Fluturo, o shqipe,
lart nëpër ajri,
si përhapet kënga
mbushur me lavdi.

Lahuta malësore
këngë të re ka nisë:
i këndon Atdheut,
i këndon Partisë.

Djersa porsi lumë,
argjend e flori
nga ball'i puntorit
rrjedh për bukuri.

Oxhaku i fabrikës
ngrihet përmbi re,
dritat e Partisë
shndrisin për mbi ne.

KËNDOJ PËR TY, ATDHE

Për ty, e dashur Shqipëri,
një zjarr i madh m'u ndez në gji
dhe ja, një vjershë do të shkruaj,
të shpreh të zemrës dashuri.

Për ty, i shtrenjti Atdheu im,
më mbushet zemra plot gëzim
kur shoh sa shpejt po përparon,
kur shoh që ecën fluturim.



TE QARTA ME VIJNE MENDIMET

Nga marshimi po kthehemi
të lodhur,
por më të fortë se kurrë.
Qyteti na fton
në gjirin e tij,
me mijra drita.
Dritë është gjithçka:

thirrja e Partisë,
vepra e popullit.
Sa të qarta më vijnë mendimet
tani.

KËNGË PËR XHAXHIN ENVER

N'ato ditë të rënda,
plot mjerim e zi,
i fale Atdheut
të madhen Parti.

Popullin që vuante
në mjerim e terr,
e ngrite në këmbë,
o xhaxhi Enver:

kushtrim' i Partisë
në luftë për çlirim,
flamur i lirisë,
diell plot shkëlqim.

Ecim gjith' mbas teje
rrugës socializmit,
shtigjet na i ndriçon ti,
diell'i komunizmit.

ME LIBRIN TËND NË DORË


Me librin tënd në dorë,
me gjakun tënd në gji
do ecim ne gjithmonë,
o nënë e shtrenjtë Parti.

SHQIPËRIA, KINA

Shqipëria, Kina
zemra të pandara,
qentë le të lehin
ne ecim përpara.

Së bashku do jemi,
në një front për jetë,
nuk na mposht dot kurrë
stuhi e tërmet.

Shqipëria, Kina
krah për krah marshojnë,
dy udhëheqësit tanë
si dielli na ndriçojnë.



PARTI E DASHUR

Parti e dashur,
Parti e shtrenjtë,
linde, u rrite
në këtë vend.

Ballë hapur ti
ndërton, vigjilon
e komunizmin
çdo ditë afron.



PARTIZANJA TRIME

Goni partizanja
mal më mal luftoi,
lodhja e mundimi
kurrë s'e pengoi.

Partizanja trime,
me pushkë të gjatë,
e rrept'në luftime,
shembull në brigatë.

Zemra shumë i digjej
për liri, vatan,
zër i saj kumbonte:
— Para partizan!

Goni partizanja
mal më mal luftoi,
plumbi edhe zjarri
kurrë s'e ndaloi.

PARTIZANI I VOGËL

— Xhaxhi merrmë mua,
atje lart, në mal,
edhe unë dua
të shkoj partizan.

Pse, mos vetëm linda
t'i shërbej shtëpisë?
Jam apo nuk jam
bir i Shqipërisë.

Buzëqeshi xhaxhi
dhe e përqafoi,
e ngriti në krahë,
në gjoks e shtrëngoi.

LIBRARI E SHTETIT
TIRANË

~~52543~~
12976

— Je i vogël, Beni,
nuk vjen dot me ne
të rritesh dhe pakëz,
pa të marr atje.

Po ty, shpirt i xhaxhit,
trim e kapedan,
kush të paska thënë
që s'je partizan?

Po djemt si ti
na duhen në fshat. . .
Dhe sakaq nga xhepi
nxori një granatë.

— Merre, — tha, — këtë,
merre, trimi im,
dhe, kur të të duhet,
hidhe me guxim.

Beni e mbështolli,
në gji e shtrëngoï,
si zogu mbi male
pastaj fluturoi.

... Shkuan shumë ditë,
gjersa një mëngjez
kish rrethuar fshatin
armik' i pabesë.

Gjerman'e tradhëtarë
në pritë kishin rënë,
ca grushte të mira
porsa kishin ngrënë.

Pa qen egërsuar,
gjak për gjak kërkonin,
dhe burrat e fshatit
do t'i pushkatonin.

— Ku janë partizanët?
Hajde, shpejt tregoni,
se nga duart tona
jo, nuk do shpëtoni.

Shpejt, shpejt tregoni,
koha nuk na pret,
i vdekur do mbetet
ai që nuk flet.

Beni kur e pa
që s'kishte shpëtim,
para tyre doli
e tha me guxim:

— Ndaluni, ç'po bëni?
Mos i pushkatoni.
Unë i di ku janë
ata që kërkoni.

Pa qeshën fashistët,
qeshën tradhëtarët,
vrapuan pas Benit,
i lanë fshatarët.

— Shpejt te komandanti,
atje le të vemi,
çetën partizane
në dorë e kemi.

Kështu thosh m'i pari,
shfrynte edhe shante,
ndërsa Benë e vogël
vendi nuk e mbante.

— Duhet të kujdesem
të vras sa më shumë,
gjaku i armiqve
të rrjedhë si lumë!

Kështu po mendonte
kur hyri te dera,
prapa po e ndiqnin
shumë oficera.


U ngrit komandanti
shpejt e shpejt në këmbë
edhe murmuriti
egër nëpër dhëmbë:

— Nuk dua ta dëgjoj
emrin partizan,
vetëm dua të di
kush këtu i mban.

— Kudo janë ata, —
Beni u përpoq
dhe rripin granatës
për një çast ja hoq.

Pa u trembur fare
aty e lëshon,
krismë ndjen e kujë
dhe pastaj mbaron.

Tymi edhe flaka
dhomën e mbuloi
Beni, trim i vogël,
ja kështu luftoi.



Ai . . .

Ai ecën krenar, ngadalë,
drejt tytave të pushkëve,
vështrimin hedhur mbi malet
dhe ndal mbi murin e lagët të burgut.

E di ai se s'do t'i shohë më ato male,
e di që s'do vështrojë më mëngjezet,
e di që s'do të takohet më me shokët,
e di që s'do ta preki më atë mur,
e di që do të ndahet nga jeta,
po nga ideali kurrë.

BUZËQESHJE PARA LITARIT

Qëndrove para litarit

kokëlart,

krenare.

Zemra të rrihte si kabanë e kuqe.

Tingujt lajmëronin se agimi i buzëqeshjeve
do shpërthente plot gjeth'e burbuqe.

PARA LAPIDARIT

Ajo nuk vdiq,
ajo jeton,
jeton gjithmonë pranë nesh,
e veshur ashtu thjesht,
me një shall të kaltër në gushë,
me një zemër të kuqe në gji.

HEROINA E TRASESË

Në trase u ngrit flamuri,
puna shpejt fillon,
dit e bukur, ditë sulmi
atje në aksion.

Zien puna, tundet dheu
gaz edhe hare,
eh, rini, rini shqiptare,
ç'zjarr e ç'forcë ke!


Vritet Shkurta, bje malësorja,
vajza pik' e trimit,
hej rapsod, rrëmbe lahutën,
zgjoje Dukagjinin.

Shihni lart, aty mbi kodër,
tek ndrit lapidari,
ku punoi e mbet për vendin
bijë e një shqiptari.

NË MES SHQIPONJAVE

Ismet Bruçajt

Tufani rreh shpinën e maleve,
mbi majat e tyre përplasen re të zeza.
Ai ecën. . .
Ecin dhe ëndrrat djaloshare,
me ëndrrat e Atdheut i rreh zemra.
Ai ecën . . .
Hapat e tij shkojnë pranë herojve,
afrohen më tepër pranë fëmijve.
Ai rron hero mes shqiponjave,
me shqiponjat ngjitet kaltërsive.
Ne e kemi bir kolektivi,
me ne ai thur ëndrrat e thjeshta,
në Atdhe ndriçon si rreze agimi,
në votrat e ngrrohta futet në biseda.
Dhe ne e pikturojmë thjeshtë në vargje,
çdo varg për të është një medalje.



UNË, PUNËTORI I TURNIT TË TRETË


Po dal nga uzina këtë mëngjez
kur dielli shkëlqen mbi oxhakët,
kur bari i përgjumur
ngre kokën plot me vesë.

Eci. . .

Në fytyrë gaz, buzëqeshje,
në ballë djersa ndrin si pika vese.

Eci mes dhjetra bisedash,
eci mes turmash të gjata njerëzish,
eci mes fytyrash ngarkuar me buzëqeshje

dhe jam krenar,
se në këto biseda,
në këto buzëqeshje
ndodhem dhe unë,
unë, punëtori i turnit të tretë.



TË PUSHTOJMË MAJËN

Ne ngjitemi,
i tillë është marshimi ynë,
ngjitemi të pushtojmë majën.
Ne s'jemi alpinistë

e trasta alpinistësh mbi shpinë
nuk mbajmë.
Ne jemi nxënës
që majat kërkojmë
të pushtojmë.
Ngjitemi, majat e shkencës të push-
tojmë.

KËNGË E THJESHTË

E thjeshtë është kjo këngë,
ashtu siç janë dhe vetë ata,
të thjeshtë.

Ata një plake i ndihmuan
që brenda në shtëpi të fuste drutë,
dhe kur plaka u tha: «faleminderit»
dhe nga një kokërr vezë desh t'u nxjerrë,
ata vunë buzën më gaz e i thanë:
«Jo, nënoke, ne jemi pionierë!»






U NISËM NE

U nisëm ne
me këngë në gojë
e shiu mbi supe na binte.
U nisëm ne
si ushtarë pararojë
dhe kënga përpara na printe.

PARTISË

Porsa kujtoj
emrin Parti,
zemra më mbushet
me dashuri.

Më mbushet zemra
gaz e hare.
Parti, e dashur
ti je për ne.



KTHIMI I TRIMIT

Malli seç e mori
trimin Skënderbe
për malet dhe fushat,
popull e Atdhe.

Thirri gjithë shokët
dhe u tha: «Vëllezër!
Në Atdhe agimi
të na zërë nesër!»

E ç'u tha, u bë.
Kuajt nisën trokun,
me trimat mbi shpinë,
që s'ua gjeje shokun.

Shikonte Atdheu
dhe fërkonte sytë:
«Janë vallë a s'janë
ata që kam pritë?»

Dhe i hapi portat
trimit të vërtetë,
prapa ndalën trokun
përmbi treqind vetë.

Ja kështu, o shokë,
erdhi në Atdhe
trimi i pavdekshëm,
Gjergji, Skënderbe.

PARA MONUMENTIT TË SKËNDERBEUT

Qëndroj para teje dhe hesht.
Shikoj fytyrën tënde burrërore,
të shoh përsëri në ball t'ushtrisë,
duke u prirë luftëtarëve në fitore.
E përsëri të shoh
me shpatën tënde në dorë,
duke u sulur mbi turqit si shqiponjë.
Dora jote e fuqishme
ngre lart
shpatën e rreptë të betejave,
dhe ti buzëqesh madhështor.
Tek të shoh majë kalit,
më kalojnë para
gjithë ata burra
që luftuan kundër sulltanit.
Duke qëndruar kështu,

mbi kalin tënd të gurtë,
krenohesh dhe ti me tonat suksese,
me prijsin tonë,
me partinë tonë të madhe e t'urtë.

KUJTIM NGA KONKURSI

A ju kujtohen, shokë, çastet vendimtare
kur spikeri i konkursit dha rezultatin?
Ç'ndjenja të forta,
mornica gëzimi
na përshkonin shtatin,
dhe s'dinim kë përqafonim,
tifoza kundërshtarë,
me një dëshirë të çuditshme në gji:
t'i bënim të gjithë të ishin fitimtarë!
A ju kujtohet, shokë,
Koha e konkurseve dhe e gzimeve të
mëdha?

SHKURTE VATËS

Një lapidar afër trasesë
krenar e çon kryet përpjetë,
atje ku fusha e Myzeqesë
e gjerë shtrihet gjer në det.

Do shushurijnë pranë tij
kallinjtë e grurit gjithë shkëlqim,
do shkojë treni si veri
mëngjez e mbrëmje pa pushim.

Dhe ti do jesh gjithmonë atje,
pranë trenave, pranë grunjave,
gjithmonë e gjallë dhe e re
pranë muzgjeve, agimeve.

MËSUESIT HERO

Qe mëngjez nëndori,
dita ndaj t'aguar.
Era të rrëmbente,
shiu kish shtrënguar.

Moti kishte mbledhur,
dukej atë ditë,
përpara Ismetit
të gjitha stuhitë.

Trimi bëhej gati
për udhë të gjatë,
gjumi s'e kish zënë
gjithë atë natë.

Që nga dhoma pranë
gjyshja kur e pa,
ju afrua ngadalë
dhe pastaj i tha:



— Biro, ti sa erdhe,
mirë s'të kemi parë,
edhe pakë ditë
e do shkosh ushtar.

— S'është ashtu, moj gjyshe.
Në fshat mua më presin.
Nxënësve u dhashë fjalën,
Partisë i dhash' besën.

Nuk ka ç'më bën shiu. —
Gjyshen përqafoi,
me radion në dorë
malit fluturoi.

Gjyshja në dritare
syt' i mban përpjetë,
ç'ju coptoka zemra
kur gjëmojnë retë.

Vendin tund furtuna,
egër vërshëllen
përpara Ismetit
çdo gjë e rrëmben.

Bjeshkët ulurijnë,
pishat fort kërcasin,
përrenj e rrëkera
tejpërtej buçasin.

Errësirë e natës
dalngadalë afron,
po mësuesi trim
ecjen s'e ndalon.

Të fortë si hekur
e bënë idealet,
pa ngjitet mbi shkrepë,
çan përpjetë malet.

Ashtu si partizanët
që ranë në luftim
shqiponjë mbi malet
mbet ai në fluturim.

BABI IM ËSHTE MURATOR


Shihni, shihni sa pallate
madhështore janë ngritur,
Durrsi ynë, qytet i bukur,
sa shumë është rritur! . .

Jam e lumtur se dhe babi
murator punon,
ngre kollona, rreshton tulla,
muret i larton.

E shoh babin kur zë ngjitet
skelave me natë,
dhe çdo javë ndërtes' e re
ngrihet nga një kat.

Aty shpejt apartament
merr një shoku im,
pastaj unë, me shok'e shoqe,
i shkoj për urim.

Sa bukur ky babi im
ndërton dhe çatitë!
Shndrisin shkollat e pallatet
shndrisin dhe shtëpitë.




NË GJIRIN TËND

Në gjirin tënd u rrita.
Ti je për mua drita
që shohin syt' e mi,
o nënë e shtrenjt' Parti.

Në gjirin tënd mësojmë
të bëhemi punëtorë,
libër, kazm' e pushkë
gjithnjë t'i mbajmë në dorë.

Ne jemi bijt' e tu,
të fortë si çelik,
në udhët komuniste
s'na ndal asnjë armik.

Dhe sot unë, bija jote,
Parti, ty të premtoj,
për ty e për Atdhenë
pareshtur do punoj.



ME LLAMBA DO TË SHKRUAJMË

Do ngjitemi në male
dhe shtylla do të ngulim
me tela, çelsa, llamba
errësirën do ta shkulum.

Dhe dritën elektrike
do shpjemë në malësi,
me llamba do të shkruajmë:
«Lavdi për ty, Parti!»


Ç'DO TË BËHEM

Në u bëfsha traktorist,
murator, elektrikist,
gjeolog e infermier,
do punoj kudo me nder.

Po të bëhem aviator,
marinar, a murator,
do punoj unë me gëzim
për lavdinë e vendit tim.

Në u bëfsha farkëtar,
rrobaqepës, këpucar,
djersën time pa kursim
do t'ja fal Atdheut tim.

Seç do bëhem nuk e di,
se akoma jam fëmijë,
po sot duhet të mësoj
që të di si të punoj.




NJE KËNGË E RE

Dëgjoni, male,
këngën e re,
këngën e dritës
këndojmë ne.

«Male të larta,
male kreshnike,
ju dha Partia
dritë elektrike!

Aty ku kishte
veç varfëri
çove dritën, jetën,
e shtrenjta Parti!»



FESTOJMË 1 MAJIN

Ecim ballëlar
me flamur ndër duar,
zemra plot me gaz,
duart fort shtrënguar.

Këndon Shqipëria
këngën më të re
për mëmën Parti,
për ty, o Atdhe.

Ditën e 1 Majit
vit për vit festojmë
flamujt e fitores
dhe më lart i çojmë.

DO RRITEM PËR SHQIPËRINË

Jemi si lule
të vogla fare,
që mbijnë në vazo,
lart në dritare.

Siç rriten lulet
e zënë çatinë,
do rritemi ne
për Shqipërinë.

KUFITARIT

Kufitar i vendi tim,
të kam mu në gji,
sepse tokën tonë të shtrenjtë
po e mbron sot ti.

Përmes borës, përmes shiut
nuk ke frikë
ndaj të gjithë të thërrasim
sypetrit.

Jam e vogël unë akoma
për kufi,
pa të shoh ashtu së largu
me mahni.

Kur të rritem dhe Atdheu
po e desh,
pushkë e vezme porsi Zoja
do t'i ngjesh.



Kufitar i vendit tim,
të kam mu në gji,
sepse tokën tonë të shtrenjtë
po e mbron sot ti.

DHURATË NËNËS

Po vjen sërish pranvera.
Ja, erdhi 8 Marsi.
Për nënën një dhuratë
unë dua ta bëj gati.

Po vjen sërish pranvera,
do mbledh unë manushaqe,
për festën tënde, nënë,
do të thur unë ca vargje.

Do thur për ty ca vargje,
me ta do ngre një këngë,
në ditën e 8 Marsit
do ta dhuroj, moj nënë.

NË HARTËN E BOTËS

Shpesh herë vete pranë hartës
dhe me qejf atje shikoj
gji deti, fusha, male
dhe me gisht zë i tregoj.

— Cilin vend pëlqen më shumë, —
më pyeti mësuesja mua.
Vura gishtin mbi një pikë:
— Si Atdheun, tjetër s'dua.

PISHA DHE KANDILI

Në një fshat të vogël,
që mbi mal ish ngritur,
pisha dhe kandili
rrinin të mërzitur.

Kandili i tha:
— Dëgjove, moj mike,
fshatit do t'i vijë
drita elektrike.

Ne më s'do t'u hyjmë
njerëzve në punë,
këtu, ku për shekuj
na çmuan aq shumë.

Pastaj psherëtiu
e tha i trishtuar:
— Tanimë çdo gjë
për ne ka mbaruar.


Pisha pëshpëriti:
— S'është aq lehtë,
fshati është i largët
mali i përpjetë.

Lëri ata të mburren,
mos dëgjo seç thonë,
siç kemi jetuar,
do rrojmë gjithmonë.

— Vetes, — tha kandili, —
ja bën qejfin kot,
se elektrikistët
në fshat erdhën sot.

Shtyllat shpejt i vunë,
telat gjithashtu,
ndaj jetën të gjatë
s'e kemi këtu.

Zgjati kokën pisha
gjithë helm e vrer,
pa shtyllat në radhë
edhe telat ndanë.



Mbi shtylla të tjera
pa dy punëtorë,
në sup mbanin telat
dhe pincat në dorë.

Fshati brohoriste
për nënën Parti,
që shpejt do t'i sillte
dritën në shtëpi.

— Ahere, — tha pisha,
me lot hidhërimi, —
vdekjen po na sillka
elektrifikimi.

L E N D A

	Faqe
Dy fjalë lexuesit	3
Dritat e Partisë <i>Mark Brunga</i>	5
Këndoj, për ty, atdhe! <i>Drita Osmani</i>	7
Të qarta më vinë mendimet <i>Bashkim Hoxha</i>	8
Këngë për xhaxhin Enver <i>Vasilika Xhavora</i>	10
Me librin tënd në dorë <i>Ervehe Hoxha</i>	12
Shqipëria, Kina <i>Ariana Karpli</i>	13
Parti e dashur <i>Ervehe Hoxha</i>	14
Partizania trime <i>M. Muho</i>	15
Partizani i vogël <i>F. Muçati</i>	17
Ai <i>Bashkim Hoxha</i>	23
Buzëqeshje përpara litarit <i>Ilia Dedi</i>	25
Para lapidarit <i>Bashkim Hoxha</i>	26
Heroina e trasesë <i>B. Mëhilli</i>	27
Në mes shqiponjave <i>B. Mëhilli</i>	29
Unë, punëtori i turnit të tretë <i>Bashkim Hoxha</i>	31
Të pushtojmë majën <i>Elsa Rakipi</i>	33
Këngë e thjeshtë	34
U nisëm ne <i>Elsa Rakipi</i>	35
Partisë <i>Raimonda Druga</i>	36
Kthimi i trimit <i>Hamit Menko</i>	37
Para monumentit të Skënderbeut <i>B. Mëhilli</i>	39
Kujtim nga konkursi <i>Elsa Rakipi</i>	41
Shkurte Vatës <i>Ervehe Hoxha</i>	42
Mësuesit hero <i>M. Muho</i>	43

Babi im është minator	<i>N. Hyseni</i>	47
Në gjirin tënd	<i>Luljeta Biturku</i>	49
Me llamba do të shkruajmë	<i>Shpëtim Arkaxhiu</i>	51
Ç'do të bëhem	<i>R. Rama</i>	52
Një këngë e re	<i>Sabrie Lita</i>	54
Festojmë një Majin	<i>Roland Hysi</i>	56
Do rritem për Shqipërinë	<i>Ligor Gjirja</i>	58
Kufitarit	<i>Elsa Rakipi</i>	59
Dhuratë nënës	<i>Ervehe Hoxha</i>	62
Në hartën e botës	<i>Ligor Gjirja</i>	63
Pisha dhe kandili	<i>B. Rama</i>	64

Piktor HYSEN DEVOLLI

24752
LIBRARY 3 11 1970
TIRANA

Tirazhi 3000 kopje Format 70x100/32 Stash 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970